

## FTESË

**për pjesëmarrje në aktivitete në kuadër të fushatës ndërkombëtare "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave" me moton "Jepi fund dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje"**

Te respektuar,

Kemi nderin dhe kënaqësinë t'ju ftojme të merrni pjesë në aktivitetet e rradhës që **IQF ANTIKO i organizon në kuadër të fushatës "16 ditë aktivizëm kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe asaj në familje"**. Gjatë 16 ditëve të ardhëshme anëtarët, organizatat dhe bashkëpuntorët e rrjetit IQF ANTIKO do të realizojnë **17 ngjarje-punëtori dhe tribuna në 14 bashkësi lokale të R. Maqedonisë: Tetovë, Gostivar, Resnje, Probishtip, f. Budakovë-Mogillë, Kumanovë, Likovë, Jegunovcë, Dellçevë, Kërçovë, Tearcë, Shuto Orizarë-Shkup, Kanatlarcë - Prilep dhe në komunën e Aerodromit**. Përveç punëtorive dhe tribunave do të realizohet edhe shpërndarja e materialeve informative, promovuese dhe edukative.

**Objektivat e aktiviteteve të fushatës dhe materialeve edukativo -promovuese është:** Dhenia e kontributit në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe informimit mbi masat që duhet të merren në lidhje me zgjidhjen e problemit të dhunës së ushtruar ndaj grave dhe vajzave, si dhe dhunës në familje, në nivel lokal dhe në atë kombëtar.

**Gjegjësisht, qëllimi ynë kryesor është:** parandalimi i dhunës dhe përmirësimi i shërbimeve për mbrojtjen e viktimave të mundshme, por edhe aktivizimi i **të gjitha institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe aktorët të tjerë të interesuar**, të sigurojnë pjesëmarrje aktive, të organizuar, koordinuar dhe efikase në përpjekjet e tyre në parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, në përputhje me "Ligjin për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje".

Aktivitetet e fushatës kanë për qëllim sensibilizimin e të rinjve nga rajonet urbane dhe rurale si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore në drejtim të formimit të qëndrimeve pozitive ndaj barazisë gjinore dhe mundësive të barabarta për të gjithë, në mënyrë që të eliminohen paragjykimet gjinore dhe stereotipet që krijojnë "tokë pjellore" për të mbështetur dhunën.

Me këtë fushatë IQF ANTIKO jep një kontribut aktiv në krijimin e një bote më të sigurt, dhe një jete më dinjitoze pa prezencë dhune, bazuar në respektimin e të drejtave individuale të njeriut.

Fushata është e organizuar dhe mbështetur financiarisht në kuadër të Granteve Institucionale CIVICA Mobilitas.

Informata më të hollësishme rreth ngjarjeve dhe aktiviteteve të këtij viti munt ti gjejni në tabelën ose në faqen e internetit të ANTIKO-s [www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk).

Me respekt,

**INICIJATIVA QYTETARE E FEMRAVE ANTIKO**



	Data	Komuna	Lokacioni	Ora	Lloji dhe tema i aktivitetit
1	25.11.2017	14 komuna	14 komuna	TBD	<b>Shtypi konferencë - Dekleratë për medime, Shpallja e ngjarjeve</b>
2	27.11.2017	Tetovë	Sh. F. "Goce Dellçev"	11-13 h	Punëtori me përfaqesues të shërbimit pedagogjik në temë "Hapat drejt një mbrojtjeje më të mirë nga dhuna ndaj grave dhe vajzave dhe ajo në familje"
3	27.11.2017	Resnje	Këshilli Komunal- Resnje	15-17 h	Punëtori me gra dhe vajza për "Planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse dhe shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës"
4	28.11.2017	Probishtip	Sh. F. "Braça Milladinovci"	13-15 h	Punëtori me nxënës të klasës së 9-të në temën "Njohja dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"
5	28.11.2017	Komuna Aerodrom	Bashkësia urbane - Gorno Lisiçe - Perëndim	19-20 h.	Punëtori me gra dhe vajza në temën: "Njohja, parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"
6	29.11.2017	Mogillë	Sh. F. "Braça Milladinovci" – F. Budakovë	12-14 h	Punëtori me gra dhe vajza nga zonat rurale në temën "Njohja dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"
7	29.11.2017	Kumanovë	Sh. F. "Braça Ribar" – F. Sopot	11-13 h	Punëtori me gra dhe vajza nga zonat rurale në temën "Njohja dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"
8	30.11.2017	Likovë	Salla e Këshillit Komunal- Likovë	13-15 h	Punëtori intersektoriale në temën "Planifikimin i koordinuar dhe zbatimi i masave për mbështetje dhe mbrojtje nga dhuna gjinore dhe asaj në familje "
9	30.11.2017	Jegunovcë	Sh.F. Simçe Nastovski – F.Vratnicë	12-14 h	Punëtori me nxënës të klasës së 8-9të në temën "Dhuna me bazë gjinore"
10	01.12.2017	Gostivar	Qendra për Kujdesin Social Gostivar	12-14 h	Punëtori intersektoriale në temë: "Veprimi i koordinuar - marrja e masave adekuate nga të gjitha shërbimet relevante në fushëveprimin dhe kompetencat që i kanë në lidhje me dhunën gjinore dhe asaj në familje "
11	01.12.2017	Delçevë	Qendra ditore për personat me aftësi të kufizuara	11-13 h	Punëtori me të rinj me nevoja të veçanta në temë: "Mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"

12	04.12.2017	Kumanovë	Këshilli Komunal - Kumanovë	12-14 h	Punëtori intersektoriale tema: <b>"Veprim i koordinuar - planifikimi i shërbimeve për fuqizim dhe mbështetje të viktimave të dhunës"</b>
13	04.12.2017	Kërçovë	Sh.M.K. Drita	14-16 h	Punëtori me nxënës të shkollave të mesme në temë: <b>"Njohja dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"</b>
14	05.12.2017	Tearcë	Sh.F. Kirill Pejçinoviç	12:30-14:30h	Punëtori me nxënës të klasës 8-9 në temën <b>"Njohja dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"</b>
15	06.12.2017	Gostivar	Kryqi KUQ -Gostivar	12-14 h	Punëtori me të rinj në temën <b>"Format e dhunës kundër grave dhe vajzave dhe asaj në familje- masat mbrojtëse"</b>
16	06.12.2017	Tetovë	Sh.M.K Kirill Pejçinoviç	13-15 h	Punëtori me nxënës të shkollave të mesme nga viti 1 deri në 4 në temën <b>"Njohja dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"</b>
17	07.12.2017	Shuto Orizar	Sh. F. "26 Juli"-Shkup	12-14 h	Punëtori me nxënës të klasës 8-9 në temën <b>"Njohja dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore"</b>
18	07.12.2017	Prilep	Sh. F Kiril i Metodi – F. Kanatllarcë	12-14 h	Punëtori me gratë nga zonat rurale në temën <b>"Format e dhunës kundër grave dhe vajzave-masat mbrojtëse"</b>
19	09.12.2017	14 komuna	14 komuna	TBD	<b>Konfernc për Shtyp</b> - Deklaratë për mediat, raportim për aktivitetet e zbatuara dhe rezultatet.